



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.779/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Qëndresë Hajrizi, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar korrigjimin e votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë.

## **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar** apeli Anr.779/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Qendresë Hajrizi, nga Podujeva, Kandidate për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, më datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.779/2021, të paraqitur nga Qendresë Hajrizi, nga Podujeva, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi, i vendvotimeve 1813E/01R, në fshatin Metehi për arsye se ka vërejtur parregullsi, pasi që në FRK figuron vetëm një votë, kurse nga raportet e vëzhguesve, figurojnë 11 vota. Lidhur me këtë ankesë gjeni dëshmitë e vëzhguesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Qendresë Hajrizi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Xhevdet Maloku kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, të paraqitur me datën 04.11.2021 dhe është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton fakti se Apeli i parashtruar nga Qendresë Hajrizi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Komunën e Podujevës, dega në Komunën e Podujevës, është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.779/2021 më datën 06.11.2021

**Kryesues i Panelit**  
Ferki Xhaleri



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.